

# Njoftim - U zhvillua takimi me përfaqësues të Programit Gjerman për prezantimin e mundësisë për intership në Gjermani.

Dje, në sallën “AULA MAGNA”, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, u zhvillua takimi i përfaqësuesve të programit gjerman në Tiranë me studentët e Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit .

Ky takim kishte për qëllim prezantimin e mundësive për intership që programi Gjerman ofron për studentët e Ballkanit, kryesisht të profilit inxhinierik. Këto intershipe janë të paguara dhe zgjasin 3 deri në 6 muaj.

Studentët ndoqën me shumë interes informacionin mbi këtë program prestigjioz, mundësinë e ekspozimit ndaj një shumëllojshmërie përvojash, idesh inovative dhe pikëpamjesh që të rrisin në nivel profesional dhe personal.

